

KARTELË INFORMATIVE

AL101005

1. Emri i shërbimit	Përfitim nga "Fondi i Konkurrueshmërisë" i akorduar nga buxheti i shtetit			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Ky fond ka për qëllim të mbështesë dhe të përmirësojë kapacitetet e NVM-ve shqiptare në mënyrë që ato të jenë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të tregut si kombëtar dhe ndërkombëtar.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Ky shërbim ofron rimbursimin në masën 70 % të kostove të miratuara. Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 1,400,000 Lek për një projekt; Pagesa e fondit të përfiturar bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/ faturave e cila/ të cilat vërteton/ vërtetojnë shpenzimet e kryera;			
4. A jam përfutues?	- Biznese të klasifikuara si mikro, të vogla, apo të mesëm sipas ligjit Nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar. - Biznese me fokus prodhimin dhe eksportin, të cilat prodhojnë produkte dhe/ose shërbime që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel ndërkombëtar;			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Akti i regjistrimit të subjektit	Qendra Kombëtare e Biznesit	Po
	2	Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ndërmarrjes.	Studio e licensuar	Po
	3	Në rastet kur bilanci është negativ, ndërmarrja duhet të dorëzojë një vërtetim bankar që vërteton që ndërmarrja ka në llogari bankare një shumë të barabartë me buxhetin e projektit;	Bankë	Po
	4	Dokumenti i identifikimit, i njohur nga ligji, i personit që paraqet kërkesën në emër të subjektit	Aplikanti/ Personi i autorizuar	Po
	5	Autorizimi që vërteton se personi i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të aplikuar dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit	Personi i autorizuar	Po
	6	Buxheti i projektit "i detajuar sipas zërave" dhe i shoqëruar me planin e biznesit respektiv	Aplikanti	Po
	7	Evidenca për produktet e prodhuara ose që do të prodhohen; Evidenca për shërbimet e ofruara ose që do të ofrohen	Aplikanti	Po
	8	Vërtetim tatimor	Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Jo
	9	Vërtetim i pagesës së sigurimeve shoqërore	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	Jo
	10	Ekstrakti historik	Qendra Kombëtare e Biznesit	Jo
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve	Tiranë	Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kryeministria, Kati III	E hënë- E enjte, ora: 8:00-16:30 E premte, ora: 8:00- 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë Shërbim pa pagesë	Tarifa shtesë	Tarifa Online Nuk ka	Mënyra e pagesës
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Minimalisht 1 muaj nga momenti i aplikimit.			
10. Çfarë përfitoj?	Marrëveshje, e cila nënshkruhet midis aplikantit dhe institucionit dhe vërteton përfitim të fondit.			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Sipas afatit të përcaktuar në marrëveshje, në varësi të projektit për të cilin është aplikuar.			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në: E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al AIDA web: aida.gov.al / ; info@aida.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Orari Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E Hënë- E Premte, ora 08:00-19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input checked="" type="checkbox"/>
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		<input checked="" type="checkbox"/>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Urdhëri nr.102, datë 19.03.2019, "Për Miratimin e Rregullores së Funkcionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë".			